

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK**

**Procesverbal për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës së prokurimit në lote me objekt “Materiale për rrjetin e ndriçimit”**

I mbajtur sot në datë 21.09.2023 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt “Materiale për rrjetin e ndriçimit”, me fondi limit 79.047.600 (shtatëdhjetë milion e dyzet e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur**. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

**Së pari**, kemi të bëjmë me të njëjtën familje mallrash, pra me natyrë të njëjtë, që në thelb i përkasin të njëjtës kategori.

**Së dyti**, Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin, ndër të tjera, investime dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik. Ndrëuesit dhe shtyllat e ndriçimit janë dy elementë komplementarë, që instalohen njëkohësisht dhe në mënyrë paralele me njëra tjetrën. Për këtë arsye është e domosdoshme që të ketë përputhshmëri të plotë në specifikimet teknike midis shtyllës dhe ndrëuesit. Gjithashtu disa ndrëues janë kërkuar të pajisur me sisteme Smart, të cilët duhet të instalohen dhe duhet të jete ne përputhje me sistemin online të monitorimit dhe menaxhimit të rrjetit të ndriçimit publik të AK-së. Si rrjedhim, furnizimi i kërkuar nuk mund të copëzohet për shkak se shtyllat dhe ndrëuesit, përgjithësisht instalohen apo montohen njëkohësisht.

Në këto kushte, krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa operatorë ekonomikë, ku AK-së do ti duhet të presë furnizimin e njërit mall nga njëri operator dhe furnizimin e mallit tjetër nga operatori tjetër, sipas loteve, ofron pasiguri, konfuzion, kosto shtesë, vonesa duke vështirësuar në ushtrimin e detyrave të AK-së apo mosrealizim të punëve sipas objektivave. Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe

referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash, komplementare të njëra-tjetrës, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**